



**INFORMACIONE  
DHE KËSHILLA  
NË KOSOVË**

**UDHËZUES  
PËR GJERMANI**

# HAPAT E PARË: ORIENTIM DHE KËSHILLIM

**Ju planifikoni të largoheni nga Kosova dhe të shpërnguleni në Gjermani? Kur shpërnguleni në një vend tjetër, duhet të organizoni shumë gjëra dhe gjithashtu të merrni parasysh kërkesat ligjore.**

**Kjo broshurë ju tregon se çka duhet të bëni për t'u shpërngulur. Mund të lexoni se ku mund të merrni informacione, këshilla dhe seminare falas. Me ndihmën e broshurës mund të përgatiteni qysh në Kosovë për jetën tuaj në Gjermani.**

**Ju urojmë shumë suksese në përgatitjet tuaja dhe një fillim të mbarë në Gjermani!**

# Vizë dhe leje qëndrimi

Personave me pasaportë të Kosovës u lejohet pa vizë për maksimum 3 muaj brenda 6 muajve të hyjnë në Gjermani, për shembull për të vizituar miqtë ose për të udhëtuar në zonën Shengen. Nëse deri në 3 muaj jeni pa vizë në Gjermani, nuk ju lejohet të punoni.

## Llojet e vizave për qëndrime profesionale dhe private

Për një qëndrim më të gjatë për arsye profesionale ose private, ju duhet një vizë nacionale. Ju mund të aplikoni për një leje qëndrimi për qëllime punësimi (d.m.th. për të punuar), për qëllime arsimimi ose për qëllime të bashkimit familjar.

Ka viza të ndryshme, ndër të tjera

- për të punuar: si akademik/e, si punëtor i kualifikuar me formim profesional të njohur në Gjermani, si punëtor i kualifikuar me formim profesional dhe përvojë profesionale të njohur jashtë vendit,
- për të studiuar,
- për të bërë formim profesional,
- për të bërë një shërbim vullnetar, një program au pair ose një praktikë,
- për të qenë te familja juaj.

## Më shumë informacion dhe këshilla mbi temën

Cilat lloje të vizave dhe rregullave ekzistojnë, dhe veçanërisht për njerëzit nga Kosova? Faqja e internetit "[Make it in Germany](#)" ofron informacion në lidhje me këtë.

Si mund të aplikoj për vizë? Faqja e internetit e Diakonie „[I përgatitur dhe i suksesshëm në Gjermani](#)“ ofron informacion në lidhje me këtë në gjermanisht, serbisht, shqip dhe gjuhë të tjera.

Cilat kërkesa janë në fuqi? Si mund të aplikoj për vizë? Cilat dokumente më duhen? Për këtë jepen informacione në faqen e [internetit të Ambasadës Gjermane në Kosovë](#).

Këshilltarët/et në projektin “I përgatitur dhe suksesshëm për në Gjermani” nga Diakonie dhe Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë (APPK) ofrojnë informacione për të gjitha temat në lidhje me vizat dhe lejet e qëndrimit. Ju lutem t’i kontaktoni me telefon, email ose personalisht.

### Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë APPK

Rruga Rexhep Krasniqi nr. 59

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës / Republic of Kosovo

Tel.: +383 (0) 38 554 155

+383 (0) 38 554 166

+383 (0) 44 507 628

[facebook.com/appkorg](https://facebook.com/appkorg)

[appk.amif@gmail.com](mailto:appk.amif@gmail.com)

[www.appk.org](http://www.appk.org)

[www.legal-migration.de](http://www.legal-migration.de)



# Njohje e gjuhës gjermane, kurse gjermane dhe certifikata gjermane

# 2

Njohjet e mira të gjuhës gjermane janë të rëndësishme për një fillim të suksesshëm në Gjermani.

Një nivel i caktuar gjuhësor është shpesh një parakusht që një person të mund të jetojë, të punojë dhe të mësojë në Gjermani.

Nëse dëshironi të vini për t'u bashkuar me burrin ose gruan ose partnerin tuaj të së njëjtës gjini, në përgjithësi do t'ju nevojiten aftësi gjuhësore të thjeshta (niveli A1), por ka shumë përjashtime. Nëse dëshironi të filloni punë, arsimim ose studime në Gjermani, zakonisht ju nevojiten aftësi gjuhësore të mesme (të paktën niveli B1), por pjesërisht edhe një nivel më i lartë gjuhësor. Për shembull, shkollat profesionale në Gjermani dhe shumë kompani për formim profesional rekomandojnë ose ndonjëherë kërkojnë aftësi të mira gjuhësore (niveli B2).

Çfarë niveli gjuhe ju nevojitet për çfarë qëllimi? Dhe me cilën certifikatë ju mund të dëshmoni për ta vërtetuar atë? Informacion për këtë japin faqja e internetit e [Ambasadës Gjermane](#) dhe faqja e internetit e [Goethe-Institut](#) (Institutit Goethe).

Dëshironi të bëni një kurs gjermanisht? Kur të zgjidhni, duhet t'i kushtoni vëmendje cilësisë. Mësuesit duhet të kenë konfirmimin e njohurive të tyre shumë të mira të gjermanishtes ose një diplomë gjermane. Dhe shkolla e gjuhës duhet të plotësojë të gjitha kërkesat ligjore. Çfarë tjetër duhet t'i kushtoni vëmendje kur zgjidhni një kurs gjerman? Më shumë informacion në faqen e internetit të [Goethe-Institut](#) (Institutit Goethe).

Ju tashmë keni njohuri të gjermanishtes por nuk keni certifikatë? Atëherë mund të bëni një provim në [Goethe-Institut](#) (Institutit Goethe) për të marrë një certifikatë.

## Këshilla dhe mbështetje

Ju mund të merrni pjesë në kurse për gjermanishten në Goethe-Institut (Institut Goethe), [i cili kushton pa pagesë](#). Goethe-Institut (Institut Goethe) ka gjithashtu shumë oferta falas. Në konsultime, për shembull, do të merrni informacion se si të mësoni mirë dhe të përgatiteni për provimet tuaja. Në trajnimet, do të mësoni, ju mësoni shumë për Gjermaninë ose ushtroni të flisni me njëri-tjetrin në gjermanisht. Ju do të merrni informacion në lidhje me aftësitë tuaja aktuale të gjuhës dhe mund të mësoni për provimet e gjermanishtes. Ju gjithashtu mund të huazoni materiale për t'ju ndihmuar të përgatiteni për provimin. Do të merrni këshilla nga mësuesit që kanë marrë shpesh provime. Ndoshta ata madje mund të ushtrojnë disa pjesë të provimit me ju.

### Edhe më shumë oferta

Dëshironi të mësoni më shumë rreth Gjermanisë dhe të përmirësoni aftësitë tuaja të gjermanishtes? Në faqen e internetit „[Mein Weg nach Deutschland](#)“ ka tekste informuese në 30 gjuhë – përfshirë serbisht dhe shqip – për jetën e përditshme dhe të punës në Gjermani. Këtu gjithashtu do të gjeni edhe ushtrime falas të gjermanishtes për nivelet e gjuhës A1 deri në B2.

Media të tjera falas – duke filluar nga aplikacionet me materiale mësimore përmes videove, podkasteve dhe lojërave e deri te mediat sociale dhe ofertat e komunitetit – mund të gjenden këtu:

[www.goethe.de/de/spr/ueb.html](http://www.goethe.de/de/spr/ueb.html)

Edhe [Deutsche Welle](#) (dojçe vele) ofron gjithashtu kurse dhe oferta për mësimin e gjermanishtes me lajme ose muzikë për nivelet e gjuhës A1 deri në C1.

Në [portalin e absolventëve](#) mund të njiheni me njerëz që po përgatiten të shpërngulen në Gjermani ose që tashmë jetojnë në Gjermani.

# 3

## Informacion për jetën e përditshme dhe të punës

Çka do të thotë të jetosh dhe të punosh në Gjermani? Çka duhet të dini për sistemin e arsimit dhe studimin në Gjermani? Përdorni këshillat individuale nëse dëshironi të përgatiteni siç duhet.

### Informacion rreth temës së punës

Dëshironi të dini më shumë rreth jetës së punës ose mundësive të karrierës në Gjermani? Faqja e internetit “[Make it in Germany](#)” jep informacion në lidhje me këtë.

Cilat informacione dhe kërkesa janë të rëndësishme për të punuar në Gjermani?

<https://legal-migration.de/alb-2/viza-dhe-leja-qendrimi/leje-qendrim-per-arsye-profesionale>

Ka mënyra të ndryshme për të kërkuar vende të lira pune në Gjermani, për shembull në faqet e internetit të autoriteteve dhe bordeve private të punës. Aty do të gjeni përgjigje për pyetjet rreth punës.

[www.arbeitsagentur.de/jobsuche](http://www.arbeitsagentur.de/jobsuche)

Goethe-Institut (Instituti Goethe) ofron gjithashtu këshilla dhe trajnime për intervista rekrutimi dhe paraqitjeje.

[www.goethe.de/de/spr/ueb/daa/all/db0/db1.html](http://www.goethe.de/de/spr/ueb/daa/all/db0/db1.html)

[www.goethe.de/prj/mwd/de/deutschueben/arbeitsuche/bewerbung.html](http://www.goethe.de/prj/mwd/de/deutschueben/arbeitsuche/bewerbung.html)

## Informacion rreth arsimimit dhe studimit

Formimi profesional që njihet nga shteti gjerman zakonisht zgjat nga 2 deri në 4 vjet. Nxënësitmësojnë teorinë në shkollën profesionale dhe fitojnë përvojë praktike në kompani. Ka mundësi të ndryshme për formimin profesional. Ju mund të gjeni informacion të plotë në faqen e internetit të Diakonie „[I përgatitur dhe i suksesshëm në Gjermani](#)“.

## Informacion rreth profesioneve formuese

Agjencia e punësimit dhe faqja e internetit “[Make it in Germany](#)” ofrojnë informacion për profesione dhe veprimtari të ndryshme.  
<https://web.arbeitsagentur.de/berufenet>  
<https://abi.de>

## Informacion rreth studimit në Gjermani

Dëshironi të studioni në Gjermani? Në faqen e internetit të Diakonie „[I përgatitur dhe i suksesshëm në Gjermani](#)“ ka informacion në lidhje me vizat dhe lejet e qëndrimit për të studiuar.

Çfarë shkolla të larta ka në Gjermani? Cilat parakushte më duhen?  
[Shërbimi Gjerman i Shkëmbimit Akademik \(DAAD\)](#) jep informacion në lidhje me këtë në këshillime dhe evenimente.

Faqja e internetit “[Studimi në Gjermani – vendi i ideve](#)” ofron gjithashtu informacion për personat që janë të interesuar të studiojnë në shkolla të larta.

Ku mund të bëj njohjen e certifikatës sime të gjuhës për studimet?  
[Goethe-Institut](#) (Instituti Goethe) jep informacion në lidhje me këtë në faqen e tij të internetit.



## Këshilla dhe mbështetje

Ka qendra të ndryshme këshillimi dhe mundësi mbështetëse për temat e jetesës, punës, arsimimit dhe studimit në Gjermani.

### I përgatitur dhe i suksesshëm për në Gjermani – këshilla për migracionin para ardhjes (Diakonie/APPK Kosovë)

Ekspertët/et e projektit “I përgatitur dhe i suksesshëm në Gjermani” nga Diakonie dhe Beschäftigungsförderungsagentur Kosovo (Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë) APPK ofrojnë këshilla individuale:

- Përgatitja për **integrim** në shoqëri dhe në tregun e punës
- Ndihmë në **njohjen e kualifikimeve profesionale**
- **Integrimi i suksesshëm i familjes apo i fëmijëve në sistemin arsimor**
- **Siguria financiare/shëndeti**
- Mbrojtje ndaj ofertave jo serioze, shfrytëzimit nga puna dhe llojeve të tjera të varësive
- Trajnim për aplikim
- Trajnim para integrit (informacione të ndryshme për jetën e përditshme në Gjermani)
- Evenimente informative mbi temat “Sistemi i dyfishtë në Gjermani” dhe “Procesi i bashkimit familjar”

### Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë APPK

Rruga Rexhep Krasniqi nr. 59

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës / Republic of Kosovo

Tel.: +383 (0) 38 554 155

+383 (0) 38 554 166

+383 (0) 44 507 628

[facebook.com/appkorg](https://facebook.com/appkorg)

[appk.amif@gmail.com](mailto:appk.amif@gmail.com)

[www.appk.org](http://www.appk.org)

[www.legal-migration.de](http://www.legal-migration.de)

## Të jetosh dhe të punosh në Gjermani (Instituti Goethe)

Këshilltarët/et ofrojnë mbështetje dhe informacion për:

- Këshilla për të punuar në Gjermani
- Evenimente për jetesën dhe punën
- Trajnim për aplikim
- Workshop online „Mit Deutsch in den Beruf“ (“Me gjermanishten në profesion”)
- Deutschlandheft (librezë me njoftime të ndryshme) me informacione të përgjithshme dhe këshilla se ku mund të lexoni më shumë. Aty ju gjithashtu do të gjeni fjalë dhe fjali të dobishme për jetën e përditshme në Gjermani.
- Gjermani-Kurs me ushtrime falas për hapat e parë në Gjermani

### Instituti Goethe

Goethe-Zentrum Prishtinë  
Mujo Ulqinaku 19-215  
10000 Prishtinë

Tel.: + 383 (0) 38 224 909

E-Mail: [info@goethe-ks.org](mailto:info@goethe-ks.org)

[www.goethe.de/resources/files/pdf189/goethe-institut\\_mein-deutschlandheft.pdf](http://www.goethe.de/resources/files/pdf189/goethe-institut_mein-deutschlandheft.pdf)

[www.goethe.de/prj/mwd/de/mein-deutschlandkurs.html](http://www.goethe.de/prj/mwd/de/mein-deutschlandkurs.html)



© Louisa Summer

## Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Qendra Gjermane e Informacionit për Migrim, Arsim dhe Karrierë (DIMAK)  
ofron këshillime për tema të ndryshme:

- Informacione mbi migrimin për punë ose arsim
- Këshillim dhe përkrahje për personat që janë kthyer nga Gjermania apo vende të tjera dhe dëshirojnë të riintegrohen në shoqërinë kosovare.

### GIZ

Arkitekt Karl Gega, Nr. 38  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.: +383 38 233 002 106

E-Mail: [dimak-kosovo@giz.de](mailto:dimak-kosovo@giz.de)

Facebook: [DIMAK Kosovo](#)



© GIZ/DIMAK



© GIZ/DIMAK

# Njohja e kualifikimeve profesionale të huaja

## Kërkesa për njohjen

Ju keni një certifikatë mbi përfundim të shkollës, një diplomë të shkollës së lartë ose një përfundim të një formimi profesional në Kosovë dhe dëshironi që kjo të njihet? Më poshtë do të gjeni informacionin më të rëndësishëm.

## Dëshmi se keni një diplomë të shkollës së lartë

Në një bazë të dhënash për njohjen e diplomave të shkollës së lartë dhe kualifikimeve profesionale akademike mund të mësoni nëse kualifikimi juaj i huaj konsiderohet si kualifikim akademik i shkollës së lartë në Gjermani. Kjo është e rëndësishme që ju të mund të merrni një vizë ose leje qëndrimi si profesionist akademik. Nëse ushtrimi i profesionit lejohet vetëm me leje të posaçme, atëherë ju duhet edhe njohja e kualifikimeve tuaja profesionale nga autoriteti përgjegjës.

Ka profesione në të cilat mund të punosh vetëm me njohje. Këto profesione quhen "profesione të rregulluara". Këto përfshijnë, për shembull, mjekun, infermierin, mësuesin/en në një shkollë shtetërore. Agjencia e punësimit jep informacion se cilat profesione janë profesione të rregulluara.

Ju mund të gjeni informacion të plotë mbi temën "njohja e kualifikimeve profesionale" në [www.anerkennung-in-deutschland.de/html/de/index.php](http://www.anerkennung-in-deutschland.de/html/de/index.php).

Rezultati i procedurave të njohjes është shumë individual dhe ka shumë gjëra që janë për t'u marrë parasysh. Vetëm përmes këshillave personale ju mund të mësoni se cila rrugë ka kuptim për ju.

## Pika këshillimi dhe e kontaktit

Këshilltarët/et në projektin “I përgatitur dhe suksesshëm për në Gjermani” nga Diakonie dhe APPK-ja ju mbështesin dhe punojnë ngushtë me autoritetet përgjegjëse në Gjermani. Ekspertët/et do t'ju këshillojnë në shqip, gjermanisht dhe anglisht. Ju lutem t'i kontaktoni me telefon, email ose personalisht.

### Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë APPK

Rruga Rexhep Krasniqi nr. 59

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës / Republic of Kosovo

Tel.: +383 (0) 38 554 155

+383 (0) 38 554 166

+383 (0) 44 507 628

[facebook.com/appkorg](https://facebook.com/appkorg)

[appk.amif@gmail.com](mailto:appk.amif@gmail.com)

[www.appk.org](http://www.appk.org)

[www.legal-migration.de](http://www.legal-migration.de)



© APPK



© APPK

# 4

## Mbërritja në Gjermani

Ju sapo keni ardhur në Gjermani? Atëherë duhet të aplikoni për lejen tuaj të qëndrimit në zyrën e imigracionit (“Ausländerbehörde”) në ditët e para dhe të regjistroheni në vendbanimin tuaj. Keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë? Ka institute që do t'ju ndihmojnë falas dhe nuk do t'i tregojnë askujt për këtë.

## Këshilla dhe mbështetje

### Këshilla për migracionin

Ka shumë qendra këshillimi për migracionin në rajone të ndryshme të Gjermanisë. Kompetente është qendra e këshillimit të migracionit në rajonin ku do të dëshironit të jetoni më vonë. Nëse jeni i rritur, Shërbimi i Këshillimit të Migracionit për emigrantët/et e rritur (MBE) është kompetente për ju në Gjermani. Nëse jeni nën 28 vjeç, Shërbimi i Migracionit për Rininë do të kujdeset për ju. Shërbimi i Këshillimit të Migracionit për emigrantët/et e rritur (MBE) dhe Shërbimi i Migracionit për Rininë (JMD) ofrojnë këshilla për çështje që lidhen me lejet e qëndrimit dhe jetën e përditshme.

Në faqen e internetit të Zyrës Federale për Migracionin dhe Refugjatë mund ta gjeni Qendrën lokale të këshillimit.

Shërbimi i Këshillimit të Migracionit për emigrantët/et e rritur (MBE) dhe Shërbimi i Migracionit për Rininë (JMD) ofrojnë gjithashtu këshillime online.

[www.migrationsberatung.org/de/migrationsberatung-online](http://www.migrationsberatung.org/de/migrationsberatung-online) (për të rritur)

[www.jugendmigrationsdienste.de](http://www.jugendmigrationsdienste.de) (për persona deri 27 vjeç)

## Shtëpitë e informacionit dhe trajnerët e mirësearchjes të Goethe-Institut (Institut Goethe)

Trajnerët e mirësearchjes do t'ju mbështesin kur të mbërrini në Gjermani. Ata organizojnë evenimente informative, seminare (online) dhe punëtori mbi temën e të jetuarit dhe të punës në Gjermani. Trajnerët e mirësearchjes do t'i gjeni në 6 Goethe-Institut (Institut Goethe) në Gjermani dhe në qendrat e informacionit të Goethe-Institut (Institut Goethe).

Shtëpitë e informacionit janë të vendosura në 50 vende në Gjermani. Aty gjithashtu mund të mësoni më shumë rreth jetesës dhe punës në Gjermani dhe të ushtroni gjermanishten. Mund të njiheni me ofertat lokale, të merrni pjesë në ngjarje dhe të njiheni me njerëz të tjerë. Shtëpitë e informacionit janë të vendosura në institucione publike, si p.sh. autoritetet, bibliotekat dhe shkollat e larta popullore (Volkshochschulen).



**Qendrat Rajonale të Mirëseardhjes ofrojnë këshilla dhe mbështetje për punëtorët e kualifikuar dhe familjet e tyre.**

[www.make-it-in-germany.com/de/service/beratung-anlaufstellen/in-deutschland](http://www.make-it-in-germany.com/de/service/beratung-anlaufstellen/in-deutschland)

**Në qendrat kundër diskriminimit ju mund të merrni mbështetje në çështjet rreth diskriminimit.**

[www.antidiskriminierungsstelle.de/DE/wir-beraten-sie/wir-beraten-sie-node.html](http://www.antidiskriminierungsstelle.de/DE/wir-beraten-sie/wir-beraten-sie-node.html)

**Një pasqyrë përmbledhëse mbi pikat këshillimore dhe të kontaktit, autoritetet dhe kurset e gjermanishtes ju mund të gjeni në afërsinë tuaj në faqen e internetit të Goethe-Institut (Instituti Goethe).**

<https://www.goethe.de/prj/mwd/sq/hilfefinden/wichtigeadressen.html>

### **Këshilla për situata të ndryshme problematike**

Ofertat e këshillave dhe mbështetjes nga shoqatat e mirëqenies Arbeiterwohlfahrt, Caritas, Diakonie, DRK (Kryqi i Kuq), Paritätischer Wohlfahrtsverband, Qendra e Mirëqenies për Hebrenjtë në Gjermani (ZWST) janë në dispozicion për tema të ndryshme, për shembull **familja dhe fëmijët, sëmundjet, borxhet, lejet e qëndrimit, përditshmëria, integrimi dhe sigurime.**

Ju mund të gjeni informacione rreth shërbimeve këshillimore pranë vendbanimit tuaj në faqet e internetit të shoqatave, për shembull në [www.diakonie.de/informieren/einrichtungssuche](http://www.diakonie.de/informieren/einrichtungssuche).



## Informacione të mëtejshme

### Koha e lirë

Në shumë qytete mund të vizitoni muze, galeri, kinema dhe teatro ose të shkoni në një bibliotekë. Ju pëlqen natyra? Atëherë mund të shkoni në kopshtin zoologjik ose kopshtin botanik. Kjo gjë zakonisht kushton një tarifë hyrjeje.

Parqet dhe brigjet e lumenjve janë kryesisht falas dhe njerëzve u pëlqen të takohen atje për të bërë grill ose për not.

Ju mund të bëni sport në një klub sportiv ose në një studio fitnesi. Keni kohë dhe dëshironi të mësoni diçka të re? Atëherë mund të merrni një kurs në shkollat e larta popullore (Volkshochschulen (VHS)) afër jush.



© Ignacio Brosa, Unsplash

### Organizatat e emigrantëve

Në shumë qytete ka organizata dhe shoqata emigrantësh. Aty mund të njiheni me njerëz të tjerë, të shijoni aktivitete së bashku ose të përfitoni nga shërbimet e këshillimit. Për shembull, mund të gjeni informacione të mëtejshme në lidhjet e mëposhtme:

[www.bundeskonferenz-mo.de](http://www.bundeskonferenz-mo.de)

[www.damigra.de/dachverband/ueber-uns](http://www.damigra.de/dachverband/ueber-uns)

[www.bv-nemo.de](http://www.bv-nemo.de)

# 5

## Rreth Nesh

### Ofertat për t'u përgatitur për migrim dhe për të jetuar dhe punuar në Gjermani

**I përgatitur dhe suksesshëm për në Gjermani** këshillon dhe shoqëron personat që duan të migrojnë në Gjermani. Keni nevojë për informacion për këtë apo dëshironi të dini nëse planet tuaja mund të realizohen? Dëshironi mbështetje në planifikimin dhe përgatitjen e udhëtimit tuaj? Atëherë ju jeni në vendin e duhur për këtë projekt.

Mbështetja fillon në Kosovë. Ekspertët/et ju ofrojnë këshilla individuale dhe evenimente informative me informacion të përgjithshëm rreth kërkesave ligjore dhe jetës në Gjermani. Ju gjithashtu mund të merrni pjesë në seminare grupore mbi tema të përditshme dhe njohuri për Gjermaninë. Ekspertët/et mbështesin njerëzit për migrimin në Gjermani dhe në përgatitjen për jetën atje, për shembull në procesin e vizave, në aplikimin për leje qëndrimi, në integrimin e suksesshëm profesional, në njohjen e kualifikimeve profesionale, në integrimin në shkollë, arsimim dhe studime, në integrimin social dhe në çështjet në lidhje me familjen, strehimin, sigurinë financiare, sistemin shëndetësor dhe mbrojtjen kundër ndërmjetësimeve dhe ofertave të dyshimta për punë, shfrytëzimit të punës dhe llojeve të tjera të varësive.

Këshilluesit/et punojnë ngushtë me qendrat e këshillimit në Gjermani. Këshilla është e pavarur dhe pa pagesë. Fondi për Azilin, Migracionin dhe Integrimin dhe i autorizuari i Qeverisë Federale për Migracion, Refugjat dhe Integrim dhe për Anti-Racizmin e financojnë këtë projekt.

**Diakonie** është një nga shoqatat më të mëdha të mirëqenies në Gjermani, të tjera përfshijnë Caritas, Arbeiterwohlfahrt (AWO), Kryqi Kuq Gjerman (DRK), Deutscher Paritätischer Wohlfahrtsverband (Der Paritätische) si dhe Qendra e Mirëqenies për Hebrenjtë në Gjermani (ZWST). Diakonie ofron shërbime të shumta mbështetëse dhe qendra këshillimi për migrimin/integrimin. Ajo këshillon për problemet financiare, sëmundjet, familjen dhe edukimin. Projekti i Diakonie “[Puna sociale e migracionit ndërkombëtar](#)” mbështet shtigjet praktike të ofertave të para-integrimit si “I përgatitur dhe i suksesshëm në Gjermani”. Në Kosovë, Diakonie punon me [Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë APPK](#).

### **Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë APPK**

Rruga Rexhep Krasniqi nr. 59

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës / Republic of Kosovo

Tel.: +383 (0) 38 554 155

+383 (0) 38 554 166

+383 (0) 44 507 628

[facebook.com/appkorg](https://facebook.com/appkorg)

[appk.amif@gmail.com](mailto:appk.amif@gmail.com)

[www.appk.org](http://www.appk.org)

[www.legal-migration.de](http://www.legal-migration.de)

---

**Diakonie** 

AGJENSIONI I PËRKRAHJES SË PUNËSIMIT KOSOVË  
BESCHÜFTIGUNGSFÖRDERUNGSAGENTUR KOSOVO  
EMPLOYMENT PROMOTION AGENCY KOSOVO

**appk**

## Aktorë të tjerë

**Goethe-Institut e.V.** (Institut Goethe) është instituti kulturor i Republikës Federale të Gjermanisë. Promovon njohjen e gjuhës gjermane jashtë vendit dhe ruan bashkëpunimin kulturor ndërkombëtar. Në projektin “[Para integrimi dhe Menaxhimi i tranzicionit – formësimi i suksesshëm i procesit të migrimit](#)”, Goethe-Institut (Institut Goethe) bën oferta për të jetuar dhe punuar në Gjermani. Njerëzit që duan të jetojnë në Gjermani për arsye profesionale ose private marrin mbështetje këtu në përgatitjen për jetën e përditshme dhe të punës. Ofertat falas përfshijnë trajnime, këshilla dhe oferta mbështetjeje për të mësuar.

### Instituti Goethe

Goethe-Zentrum Prishtina

Mujo Ulqinaku 19-215

10000 Prishtinë

Tel.: +383 (0) 38 224 909

E-Mail: [info@goethe-ks.org](mailto:info@goethe-ks.org)

<https://goethe-ks.org/newrelease>



### VORINTEGRATION UND ÜBERGANGSMANAGEMENT

Den Migrationsprozess  
erfolgreich gestalten.



**Qendra Gjermane e Informacionit për Migrim, Arsim dhe Karrierë (DIMAK)** në Kosovë shërben si qendër këshillimi për njerëzit që janë kthyer nga Gjermania, Evropa ose vende të tjera dhe kanë nevojë për përkrahje në riintegrimin social dhe ekonomik. Gjithashtu ofrohet edhe këshillim për ata që dëshirojnë të migrojnë në mënyrë të rregullt drejt Gjermanisë, Evropës ose brenda rajonit të tyre. DIMAK bashkëpunon ngushtë me partnerë kombëtarë, duke përfshirë Ministrinë e Punës. Deri në fund të vitit 2025, DIMAK do të ofrojë shërbime të drejtpërdrejta në Kosovë. Nga janari i vitit 2026, këto shërbime do të ofrohen nga partnerët kombëtarë.

**GIZ Kosovo:**

Arkitekt Karl Gega, Nr. 38

10000 Prishtinë, Kosovë

Tel.: +383 38 233 002 106

E-Mail: [dimak-kosovo@giz.de](mailto:dimak-kosovo@giz.de)

Facebook: [DIMAK Kosovo](#)

[www.giz.de/de/weltweit/298.html](http://www.giz.de/de/weltweit/298.html)

[www.startfinder.de/sq/advisory-centre/german-information-centre-migration-vocational-training-and-career-dimak-pristina](http://www.startfinder.de/sq/advisory-centre/german-information-centre-migration-vocational-training-and-career-dimak-pristina)



# 6

## Linqe të tjera të dobishme

### Informacione të përgjithshme rreth migrimit/integrimit

[www.bamf.de/DE/Themen/Integration/integration\\_node.html](http://www.bamf.de/DE/Themen/Integration/integration_node.html)

### Informacion rreth profesioneve formuese

[www.planet-beruf.de/schuelerinnen](http://www.planet-beruf.de/schuelerinnen)

### Informacion në lidhje me formimin profesional në zanate

[www.lehrstellen-radar.de/5100,90,lsrsearch.html](http://www.lehrstellen-radar.de/5100,90,lsrsearch.html)

### Informacion mbi formimin profesional komercial dhe industrial

[www.ihk-lehrstellenboerse.de](http://www.ihk-lehrstellenboerse.de)

### Informacion për punëtorë/e

[www.aktiv-online.de/beroobi-der-kanal-fuer-azubis](http://www.aktiv-online.de/beroobi-der-kanal-fuer-azubis)

### Informacioni rreth kërkimit të punës

[www.make-it-in-germany.com/de/arbeiten-in-deutschland/jobboerse](http://www.make-it-in-germany.com/de/arbeiten-in-deutschland/jobboerse)

[www.arbeitsagentur.de/vor-ort/zav/startseite](http://www.arbeitsagentur.de/vor-ort/zav/startseite)

### Këshilla për ofertat e njohjes dhe oferta të kualifikimit profesional

[www.netzwerk-iq.de](http://www.netzwerk-iq.de)

[www.migranet.org/angebote/ratsuchende/aner kennungsberatung](http://www.migranet.org/angebote/ratsuchende/aner kennungsberatung)

### Portali për ndihmën fqinjësisë

[www.start-with-a-friend.de](http://www.start-with-a-friend.de)

### Informacione të ndryshme për emigrantët e rinj

[www.handbookgermany.de/de](http://www.handbookgermany.de/de)

### Links online

[https://legal-migration.de/\\_de/beratung-und-unterstuetzung](https://legal-migration.de/_de/beratung-und-unterstuetzung)

## **Impresum**

Redaktor:

### **Diakonie Deutschland**

Evangelisches Werk für Diakonie  
und Entwicklung e.V.

Caroline-Michaelis-Straße 1

10115 Berlin

T +49 30 652 11-0

F +49 30 652 11-3333

[diakonie@diakonie.de](mailto:diakonie@diakonie.de)

[www.diakonie.de](http://www.diakonie.de)

Koncepti dhe teksti:

Maja Kliem, Alexandra Rehhorn

Bashkëpunimi i përmbytjes:

Jeannette Bell, Jürgen Blechinger, Kaltrina Fejzullahu, Nertila Furriku,  
Isabelle Schunck, Ardiana Shala, Flokart Xhafa

Përkthimi:

Dialecta

Lektori:

Janna Degener-Storr

Redaksia:

Sarah Spitzer

Kontakti:

Maja Kliem

Projekt Internationale Migrationssozialarbeit

Zentrum Flucht und Migration

Caroline-Michaelis-Straße 1

10115 Berlin

T +49 30 652 11-1457

[Maja.kliem@diakonie.de](mailto:Maja.kliem@diakonie.de)

[imsa@diakonie.de](mailto:imsa@diakonie.de)

Projektimi:

Ole Kaleschke

Foto në faqen e parë:

© Tim Hufner, Unsplash

Statusi:

Qershor 2024

---

Gefördert durch:



Bundesministerium  
des Innern  
und für Heimat

Gefördert durch:



Die Beauftragte der Bundesregierung  
für Migration, Flüchtlinge und Integration  
Die Beauftragte der Bundesregierung für Antirassismus

aufgrund eines Beschlusses  
des Deutschen Bundestages



Finanziert von der  
Europäischen Union



Baden-Württemberg

MINISTERIUM FÜR SOZIALES, GESUNDHEIT UND INTEGRATION

Diakonie

---

Verantwortlich:

Diakonisches Werk Baden in Kooperation mit der Diakonie in Württemberg

Bashkëpunimi me Diakonie Deutschland, der Diakonie Hamburg, der APPK, International Studies Institute (ISI) (Kosovo/Albanien), der Caritas Nordmazedonien, SABEV (Türkei), Faros (Bosnien-Herzegowina), EHO-Ecumenical Humanitarian Organisation (Serbien), Caritas Ukraine, Diakonie Georgien (Georgien/Armenien), den Goethe-Instituten in Etiopia, Maroku, Nigeria und den Diakonischen Landesverbänden Bayern, Bremen, Hessen, Mecklenburg-Vorpommern, Mitteldeutschland, Niedersachsen, Pfalz, Rheinland-Westfalen-Lippe, Berlin-Brandenburg-Schlesische Oberlausitz, Sachsen, Schleswig-Holstein

Projekti përkrahet nga Fondi Evropian për Azili, Migracion dhe Integrim (AMIF), Republika Federale e Gjermanisë (Komisioneri i Qeverisë Federale për Migracion, Refugjatë dhe Integrim, Komisioneri i Qeverisë Federale për Anti-Racizem dhe Zyra Federale për Migracion dhe Refugjatë – BAMF), si dhe nga shteti i Baden-Württemberg dhe Diakonie